

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Del sërish në skenë ekspertja e punësimit Kumrie Zika, ARRETSOHET nga efektivet e Tiranës për vjedhje në pesë biznese (DETAJE-PAMJE)
ADRESA	https://newsbomb.al/aktualitet/del-ne-skene-serish-skifterja-kumrie-zika-arretsohet-nga-efektivet-e-i401666
BURIMI	newsbomb.al
GJENDJA	edited

KOHA


KAPUR NGA NE	20 shtator 2026, 11:23:09 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	20 shtator 2026, 11:20:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	fe7e510b18270081e2af5f08c3fb35ea9fe8c8cbb3751e57fc4a72a6398ccf62
TEKSTI	dc6885d2bf92e0bacfb3a503767fdaa7ea0d574447096b06c80bcc65fc4dd14e
PAMJA	eb59ec4f89e4a8859ba842a0f83cdf36ae04f822784e398cfc776f8e965dbb3d

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	84a507fd4ab9b49500e730d353141c6b6e09bbf8b5f194039d37fb2c5fb84eb8
E MËPARSHMJA	064e1b2d8a0371bbffac933d3531e81a4aec1ae585381cf12107b62203b24b6b
RRËNJA MERKLE	—
ANKORIMI	nuk është ankoruar ende <i>Kjo hyrje nuk është përfshirë ende në asnjë pemë Merkle të dërguar. Zinxhiri i hash-eve provon rendin dhe integritetin; koha jo.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/84a507fd4ab9b49500e730d353141c6b6e09bbf8b5f194039d37fb2c5fb84eb8>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

12 numrat e parë FALAS!
Version PDF

Abonohu te Revista

[Kreu](#)
[Politikë](#)
[Aktualitet](#)
[Ekonomi](#)
[Kulturë & Art](#)
[Rajon](#)
[Sport](#)
[Bota](#)
[Showbiz](#)
[SocialBomb](#)


Çështjet kryesore

Haga vendos për katër ish-krerët e UÇK-së!

Arrestohet Ergys Agasi

"Retreat"-i i qeverisë në Pogradec!

Aktualitet

20 Shtator 2026, 13:20

Del sërish në skenë ekspertja e punësimit Kumrie Zika, ARRETSOHET nga efektivet e Tiranës për vjedhje në pesë biznese (DETAJE-PAMJE)




Shkruar nga Newsbomb



Arrestimi i Kumrie Zikes nga efektivet e Tiranës

E njohur si "eksperte punësimi" 39-vjeçarja Kumrie Zika, emri i të cilës është përmendur në episode të shumta grabitjesh të bizneseve, është vënë në pranga së fundmi nga blutë e Tiranës. Burime nga grupi hetimor bëjnë me dije se Zika, si në rastet e mëparshme, punësohej në subjekte të ndryshme me qëllim që të vidhte xhirot ditore.

Në vijim të punës hetimore për parandalimin dhe goditjen e krimeve kundër pasurisë, si dhe për zbardhjen e ngjarjeve të ndodhura më parë, strukturat e Komisarariatit të Policisë Nr. 1 dhe Komisarariatit të Policisë Nr. 2, në bashkëpunim të ngushtë me Forcën e Posaçme "Shqiponja" kanë bërë të mundur arrestimin e 39-vjeçares.



Revista



Abonohu tani dhe lexoje >

Lajmet e fundit



Politikë

Vettingu, rastet që tronditën Strasburgun



Showbiz & Lifestyle

"Me kthe në vendin tim..." Yli Limani u këndon çlirimtarëve të Kosovës, djali i Hashim Thaçit e falenderon publikisht: UÇK, simboli që na bashkon (POSTIMET)

Zbulu më shumë artikuj >

Kjo nuk është hera e parë që Kumrie Zika përdor të njëjtin skenar për të kryer vjedhje në biznese të ndryshme. Siç kemi raportuar dhe më parë, Zika synonte të punësohej në këto biznese dhe pastaj vijonte me vjedhjet e xhirove ditore.

Më 5 gusht ajo ka vjedhur një shumë prej 5 milionë lekësh në një pikë të këmbimi valutor në Vlorë. Ndërsa më herët më 15 korrik, pre e skemës së Zikës ra një pikë këmbimi valutor dhe transferata parash në zonën e “Varrit të Bamit”, ku ajo ishte punësuar dhe kishte ditën e parë të punës.

Duke qenë se biznesi ishte në kërkim të një punonjëseje, drejtuesit e tij e kishin rekrutuar gruan në fjalë. Zika gjatë gjithë kohës ka qenë e shoqëruar nga një punonjës tjetër, por në një moment të shkurtër, kur ai është shpërndarë për disa sekonda, ajo ka kryer vjedhjen.

Ajo ka marrë rreth 5 mijë euro nga arka e biznesit dhe më pas është larguar në rrugicat e lagjes. Sipas të dhënave paraprake, kjo është vjedhja e katërt që i atribuohet Zikës në një periudhë të shkurtër kohore.

Megjithatë, arratia e saj ka zgjatur vetëm pak minuta, pasi biznesi i dëmtuar ka njoftuar policinë. Efektivët kanë arritur ta identifikojnë menjëherë Zikën dhe më pas e kanë arrestuar në zonën e “21 Dhjetorit”.

Referuar njoftimit të Policisë, kjo mbetet e gjashta herë ku mësohet se Kumrie Zika ia ka arritur qëllimit të saj, duke vjedhur sërish xhirot ditore të pesë bizneseve të ndodhura në territoret e Komisariateve Nr. 1 dhe 2.

Kujtojmë se Kumrie Zika rezultoi të jetë një personazh i njohur publik, pasi është shfaqur më herët në televizione të ndryshme si “eksperte punësimi” dhe opinioniste për çështje që lidhen me të drejtat e punonjësve dhe tregun e punës. Ndërkohë që gjatë kësaj vere emri i saj ka kryesuar mediat për vjedhjet e kryera në biznese të ndryshme.

Njoftimi i Policisë:

Tiranë/Finalizohet operacioni policor i koduar “Skema”, i zhvilluar nga Komisariati i Policisë Nr. 1 dhe Komisariati i Policisë Nr. 2, në bashkëpunim me Forcën e Posaçme “Shqiponja”.

Punësohej në subjekte të ndryshme me qëllim që të vidhte xhirot ditore, vihet në pranga 39-vjeçarja.

Dokumentohen 5 raste vjedhjesh në subjekte të ndryshme.

39-vjeçarja u kap në ambientet e një lokali në Tiranë, nga Forca e Posaçme “Shqiponja”.

Në vijim të punës hetimore për parandalimin dhe goditjen e krimeve kundër pasurisë, si dhe për zbardhjen e ngjarjeve të ndodhura më parë, strukturat e Komisarariatit të Policisë Nr. 1 dhe Komisarariatit të Policisë Nr. 2, në bashkëpunim të ngushtë me Forcën e Posaçme “Shqiponja”, finalizuan me sukses operacionin policor të koduar “Skema”.

Si rezultat i operacionit u bë kapja dhe ndalimi i shtetases të shpallur në kërkim K. Z., 39 vjeçe, banuese në Tiranë.

Nga hetimet e kryera, dyshohet se kjo shtetase punësohej përkohësisht në subjekte të ndryshme në Tiranë me qëllim për të vjedhur xhirot ditore, përpara se të largohej.

Në kuadër të këtij operacioni u dokumentuan 5 raste vjedhjesh të ndodhura në territoret e Komisariateve Nr. 1 dhe 2.

Punohet për zbardhjen e vjedhjeve të tjera që mund të ketë kryer kjo shtetase.

Materialet procedurale i kaluan Prokurorisë, për veprime të metejshme.

Sondazh

Poll

Lexo gjithashtu



E Diel 13:25

Delvina që duhet të zbuloni!



Aktualitet

Qëlloi për vdekje gruan se kujdesej për nipërit, Hysniu i nguli th*kën Lumturisë para syve të të miturve, 14-vjeçari vuri në lëvizje efektivët e Tiranës (DETAJE)

E Diel 13:04 Newsbomb



Aktualitet

Gj*ku i derdhur në 2025 ende i "pa larë", saga e hakmarrjeve për plagosjen e dy të rinjve nga Kamza, vjet u vra babai i Klaus Jaçajt, sot Myrtaj (E PLOTË)

E Diel 12:23 Newsbomb



E Diel 12:18

Plumbat "qorr" e kapën teksa pinte kafe, niset me urgjencë drejt Tiranës 73-vjeçari që u plagos në Sarandë





Aktualitet

Heronjtë e zjarrit

E Diel 11:28



Aktualitet

Hoqën dorë nga Franca, Italia dhe Tirana për të zhvilluar bizneset në Koman dhe Pogradec, Rama na prezanton me 3 sipërmarrësit

E Diel 11:00 Newsbomb



E Diel 10:47

DEL FOTO: Ky është "Tani i Ruzhdiut", 44-vjeçari që u qëllua me breshëri plumbash në Sarandë, vjet u arrestua për plagosjen e Lamajt



Aktualitet

"O bir i nënës...", ja kush është 44-vjeçari që ra pre e atentatit në Sarandë, u vra para syve të së ëmës (PAMJE-DETAJE)

E Diel 10:16



Aktualitet

"Kërcet" arma në Sarandë, raportohet për një viktimë, plumbat kapin dhe një kalimtar të çastit, detajet e para

E Diel 10:05 Newsbomb



E Diel 09:58

Autobusi plot me mallra kontrabandë, sekuestrohen 22 mijë euro në Gjirokastrë

sekuëstronën 22 mijë euro në Gjirokastër, prangosen dy persona



Aktualitet

Dënohen me burg dy shqiptarët në
Britaninë e Madhe, u kapën duke
kultivuar drogën që do të shitej deri



Aktualitet

Pagat e magjistratëve: A luftohet
paligjshmëria me paligjshmëri?!

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.